

**VENDIM**  
**Nr. 50, datë 25.1.2017**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL PËR NDËRTIM, PËR SIPËRFAQET QË PRITEN TË NDIKOHEN NGA NDËRTIMI I SEKSIONIT TOKËSOR TË GAZSJELLËSIT TAP - SEKTORËT 5B DHE 5C (STACIONET E VALVULAVE TË SIGURISË/BLLOKIMIT), TË CILAT DO TË VIHEN NË DISPOZICION TË SHOQËRISË TRANS ADRIATIK PIPELINE AG (TAP AG) PËR PËRDORIM TË PËRHERSHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin për ndryshimin e përhershëm të statusit të tokës bujqësore dhe kalimin në tokë truall për parcelat me sipërfaqe 3 299.25 (tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë njëzet e pesë) m<sup>2</sup>, të cilat ndikohen nga ndërtimi, prej shoqërisë TAP-AG, të tre stacioneve të valvulave të sigurisë/bllokimit të seksionit tokësor të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP) - sektorët 5B dhe 5C të projektit, përkatësisht:

a) në sektorin 5B, për dy stacione në qarkun e Beratit:

i) Stacioni i Valvulave të Sigurisë/Bllokimit SVS/B 29 në Vodicë, me sipërfaqe të tokës prej 1 099.75 (një mijë e nëntëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>;

ii) Stacioni i Valvulave të Sigurisë/Bllokimit SVS/B 28 në Therepel, me sipërfaqe të tokës 1 099.75 (një mijë e nëntëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>.

b) në sektorin 5C, për një stacion në qarkun e Beratit:

i) Stacioni i Valvulave të Sigurisë/Bllokimit SVS/B 27 në Qafë, me sipërfaqe të tokës prej 1 099.75 (një mijë e nëntëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>.

2. Sipërfaqet e tokës që do të ndikohen nga ndërtimi i stacioneve të valvulave bllokuese të seksionit tokësor të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), do të vihen në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatik Pipeline AG (TAP AG) për përdorim të përhershëm.

Parcelat që ndryshojnë statusin nga tokë bujqësore në tokë truall, për tre stacionet e valvulave të sigurisë/bllokimit, jepen në lidhjen 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Berat të pasqyrojnë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore në tokë urbane (truall), respektivisht për secilën parcelë, për të tre stacionet e valvulave të sigurisë/bllokimit të projektit TAP, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi.

4. Procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të pronësisë, ndërmjet kompanisë TAP AG dhe pronarëve aktualë të këtyre parcelave, me qëllim marrjen e lejeve të nevojshme për të ndërtuar seksionin tokësor të gazsjellësit TAP - sektorët 5B dhe 5C (stacionet e valvulave të sigurisë/bllokimit), do të bëhen në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, si dhe gjithë legjislacionit tjetër në fuqi.

5. Shoqëria TAP AG dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe të vendimit nr. 245, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për përmirësimin e përditësimin e të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të bëjnë ndryshimet në regjistrat dhe kartelat e pasurisë/pasurive përkatëse, përsa i përket marrëdhënieve të pronësisë për parcelat që do të ndikohen nga ndërtimi i seksionit tokësor të Gazsjellësit TAP - sektorët 5B dhe 5C, për tre stacionet e valvulave të sigurisë/bllokimit, të cilave do t’u ndryshohet statusi nga tokë bujqësore në tokë truall.

7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Qarkut Berat, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarkun Berat për zbatimin e këtij vendimi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Lidhja nr. 1**

**TABELA E TOKAVE BUJQËSORE, TË IMPAKTUARA NGA STACIONET E VALVULAVE TË SIGURISË/BLOKIMIT  
GJATË SEKSIONIT 5B DHE 5C TË TUBACIONIT TË GAZSJELLËSIT TAP NË TOKË**

| EMRI I SVS/B   | QARKU   | ZONA KADASTRALE | EMRI     | PARCELA | STATUSI I PARCELËS | PËRDORIMI      | SIPËRFAQJA (m²) | SIPËRFAQJA E PREKUR/NDIKUAR (m²) |
|----------------|---------|-----------------|----------|---------|--------------------|----------------|-----------------|----------------------------------|
| SVS/B29        | Berat   | 3808            | Vodicë   | 449/7   | private            | TOKË BUJQËSORE | VËRTOP          | 1,099.75                         |
| Shuma SVS/B 29 |         |                 |          |         |                    |                |                 | 1,099.75                         |
| SVS/B27        | Skrapar | 3076            | Qafë     | 3/2     | publike            | TOKË BUJQËSORE | POTOM           | 252.56                           |
| SVS/B27        | Skrapar | 3076            | Qafë     | 3/1     | private            | TOKË BUJQËSORE | POTOM           | 847.20                           |
| Shuma SVS/B 27 |         |                 |          |         |                    |                |                 | 1,099.75                         |
| SVS/B28        | Skrapar | 3596            | Therepel | 81      | nuk ka informacion | TOKË BUJQËSORE | VËNDRESHË       | 1,099.75                         |
| Shuma SVS/B 28 |         |                 |          |         |                    |                |                 | 1,099.75                         |
| SHUMA          |         |                 |          |         |                    |                |                 | 3,299.25                         |

